



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**

*Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*

Tiranë më, 15.09.2015

Dokument parlamentar

**RAPORT**

**PËR DEKRETIN NR. 9205, DATË 07.08.2015, TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË, “PËR KTHIMIN PËR RISHQYRTIM NË KUVEND TË LIGJIT  
NR. 93/2015 “PËR TURIZMIN””**

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në zbatim të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës, shqyrtoi dekretin nr. 9205, datë 07.08.2015, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, “Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin””.

I ftuar në komision për të shpjeguar qëndrimin e tij në lidhje me dekretin e Presidentit të Republikës dhe për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve, ishte i pranishëm Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes si dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

Në arsyet e kthimit të ligjit, Presidenti i Republikës ka paraqitur dhe argumentat me të cilat arsyeton kthimin për rishqyrtim të tij, të cilat lidhen me:

- Nenin 31/4 , i cili bie ndesh me ligjin bazë për prokurimet publike;
- Nenin 34/2, i cili bie ndesh me nenin 13 dhe 131/1/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe me ligjin nr.8652 "Mbi organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", (në nenin 8 pika 2).
- Nenin 34 dhe 35, rregullimet ligjore të të cilëve, çenojnë parimin e sigurisë juridike .

Gjatë shqyrtimit të argumenteve të Presidentit, përfaqësuesit e mazhorancës u shprehën se:

- Parashikimi i nenit 31/4 të ligjit është i njëjtë me atë të nenit 26 të ligjit nr. 10 352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”.  
Ligjvënësi me përjashtimin nga Ligji i Prokurimeve Publike të Ligjit të Kultures e ka konsideruar të vlefshme këtë mënyrë përjashtimore pa ndërhyrë te Ligji i Prokurimeve Publike. Nëse do të ruajë të njëtat standarte procedurale ligjvënëse, Kuvendi duhet të operojë në të njëjtën mënyrë edhe me ligjin për Turizmin;
- Neni 34/2 i ligjit nuk bie ndesh me parimin e decentralizimit dhe nuk çënon të drejtën e pronësisë të pushtetit vendor, sipas nenit 113/1/b të Kushtetutës si dhe ligjit nr.8652 “Mbi organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.  
Ky nen nuk bën fjalë për marrje të pronave të paluajtshme të pushtetit vendor, por për vendosje në administrim të ministrisë përgjegjëse për turizmin, të pasurive të paluajtshme në zonat me përparësi turizmin, në funksion të politikave shtetërore të

zhvillimit të Turizmit. Gjithashtu, në kuptim të regjimit fiskal, për realizimin e të ardhurave nga ana e pushtetit vendor për pasuritë e paluajtshme nën jurisdiksionin e tyre, gjëndja nuk ndryshon.

- Rregullimet ligjore referuar nenit 34 dhe 35 të ligjit nuk prekin dhe nuk çënojnë parimin e sigurisë juridike, pasi janë në mbështetje të plotë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 34, datë 20.12.2005 i cili citon se:


*“Një nga elementet më esenciale të parimit të shtetit të së drejtës është edhe ai i sigurisë juridike, i cili, ndër të tjera, ka si kërkesë të domosdoshme faktin që ligji në tërësi, pjesë apo dispozita të veçanta të tij, në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qarta dhe të kuptueshme.... Por që të realizohet një gjë e tillë, para së gjithash, ligji duhet kuptuar saktë dhe drejt. Prandaj duhet të dalë qartë qëllimi i hartimit të tij. Ai duhet të përcaktojë mjetet e ndërhyrjes, subjektet të cilave u drejtohet, raportet e caktuara të sjelljes dhe mënyrën e zbatimit të tij. Rezultati që synohet duhet të jetë i pritshëm dhe pasojat të parashikueshme për subjektet të cilëve u drejtohet ligji në tërësi, ose dispozita të veçanta të tij”... Ligji është shumë i qartë në qëllimin e tij dhe përcakton qartë mjetet e ndërhyrjes, mënyrën dhe zbatimin e tyre.*

Deputetët e mazhorancës shprehën mendimin e tyre se argumentat e Presidentit të Republikës nuk qëndrojnë dhe për këtë arsye votuan kundër dekretit për rishqyrtimin e ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin”.


Deputetët e opozotës në komision, mbështetën argumentat e Presidentit të Republikës dhe u shprehën pro dekretit për rishqyrtimin e ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin”.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të pranishëm, vendosi t’i rekomandojë seancës plenare **rrëzimin e dekretit** të Presidentit të Republikës, nr. 9205, datë 07.08.2015 “Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin””.

Mira SHEHU

  
Relator

Eduard SHALSI

  
Kryetar